



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
KËRKESAT E LICENCIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË SHTËPISË SË
KLERIMIT DHE KUNDËRPALËS QENDRORE (CCP)

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 91, datë 31.05.2023
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 119, datë 25.07.2025

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i rregullores

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kërkesat dhe procedurat e nevojshme për licencimin dhe funksionimin e shtëpive të klerimit dhe shtëpive të klerimit si kundërpalë qendrore (CCP), sipas përcaktimit të nenit 3, pikat 10 dhe 14 të ligjit nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”.
2. Rregullorja përcakton kërkesat për licencimin, organizimin dhe kryerjen e veprimtarisë të shtëpive të klerimit dhe shtëpive të klerimit që veprojnë si CCP.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore është hartuar në bazë dhe për zbatim të nenit 197 pika 8 të ligjit Nr. 62/2020, datë 14.5.2020, ‘Për tregjet e kapitalit’, përmendur këtu si ‘Ligji’.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore gjen zbatim për shtëpitë e klerimit, sipas përcaktimit në nenin 3, pika 14, si dhe nenin 194, pika 1 të Ligjit, të cilat janë subjekt i dispozitave të Nenit 195 e në vijim të Ligjit.
2. Kjo rregullore gjen zbatim edhe për shtëpitë e klerimit që funksionojnë si CCP, sipas përcaktimit të nenit 3, pika 10 dhe nenit 195, pika 1 të Ligjit.
3. Kjo rregullore përcakton kërkesa të njësuara për licencimin dhe funksionimin e shtëpive të klerimit dhe shtëpive të klerimit që funksionojnë si CCP.

Neni 4

Përkufizime

1. Termat e mëposhtme në këtë Rregullore kanë kuptimin si vijon:
 - a) ‘Autoriteti’ është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), në mbështetje të nenit 6 të Ligjit.
 - b) ‘Subjekt kërkues’ është shtëpia e klerimit ose CCP-ja që paraqet kërkesë për licencë për funksionimin e një sistemi klerimi.
 - c) ‘Këshilli’ është Këshilli i Administrimit/Këshilli Mbikëqyrës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare.
 - d) ‘Klienti’ është shoqëria që ka marrëdhënie kontraktore me një anëtar klerimi të një CCP-je, që i jep mundësi për klerimin e transaksioneve të tij me këtë CCP.
 - e) ‘Autoriteti kompetent’ është Autoriteti rregullator i krijuar sipas ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ose Autoriteti i çdo vendi tjetër jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
 - f) ‘Marrëveshje ndërveprimi’ është marrëveshja midis dy ose më shumë CCP-ve që përfshin ekzekutimin e transaksioneve midis sistemeve.
 - g) ‘Organ drejtues’ është organi sipas parashikimit të nenit 3, pika 55 të Ligjit.
 - h) ‘Kolaterali financiar’ ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 133, datë 29.04.2023 “Për sistemin e pagesave”.

Të gjitha termat e tjera në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato të Ligjit.

KREU II KLERIMI

Neni 5 Sistemi i klerimit dhe shlyerjes

1. Sistemi i klerimit dhe i shlyerjes së transaksioneve të ekzekutuara në një treg të rregulluar ose në një platformë shumëpalëshe tregtimi, ose jashtë një tregu të rregulluar dhe një platforme shumëpalëshe tregtimi (PSHT) me tituj të dematerializuar parashikohet në nenin 194, pika 2 të Ligjit.
2. Klerimi dhe shlyerja e transaksioneve të ekzekutuara në një treg të rregulluar ose në një platformë shumëpalëshe tregtimi në Republikën e Shqipërisë, në tituj të dematerializuar të regjistruar në një depozitar të licencuar, kryhet përmes sistemit të klerimit dhe shlyerjes të operuar nga një operator i licencuar i klerimit dhe shlyerjes, me përjashtim të rastit kur bursa ose operatori i PSHT-së përzgjedh një sistem klerimi dhe shlyerjeje të administruar nga një subjekt tjetër i licencuar nga një Autoritet tjetër dhe i njohur nga Autoriteti.

KREU III KRITERET E LICENCIMIT PËR SHTËPITË E KLERIMIT DHE CCP-të

Neni 6 Kriteret e licencimit

1. Në përputhje me kërkesat e nenit 9 të kësaj rregulloreje dhe të nenit 195 e në vijim të Ligjit, personi juridik që ka për qëllim krijimin dhe/ose vënien në funksionim të një shtëpie klerimi dhe/ose për të vepruar si një shtëpi klerimi, ose kur vepron në cilësinë e kundërpalës qendrore për të garantuar klerimin dhe shlyerjen, ose në cilësi tjetër, paraqet kërkesë për licencim nga Autoriteti në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 8 të kësaj Rregulloreje.
2. Personi juridik, i përmendur në pikën 1 të këtij neni, paraqet kërkesën edhe pranë Bankës së Shqipërisë për licencimin si shtëpi klerimi të titujve në përputhje me legjislacionin në fuqi për sistemin e pagesave.
3. Licenca lëshohet vetëm për veprimtari që lidhen me klerimin dhe shlyerjen dhe përcakton shërbimet ose aktivitetet për të cilat shtëpia e klerimit dhe/ose CCP-ja është autorizuar të kryejë ose të ofrojë.
4. Shtëpia e klerimit/CCP vepron në çdo kohë në përputhje me kushtet e licencës.
5. Shtëpia e klerimit/CCP njofton pa vonesë Autoritetin për çdo ndryshim të rëndësishëm që ndikon në kushtet e licencës.
6. Shtëpia e klerimit/CCP-ja që kërkon të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar me shërbime apo veprimtari shtesë që nuk mbulohen nga licenca fillestare, i paraqet Autoritetit kërkesë për zgjerim licence. Zgjerimi i licencës bëhet në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 8 të kësaj Rregulloreje.

Neni 7

Kushtet e licencimit

1. Subjekti kërkues duhet të ndërmarrë të gjitha masat dhe të hartojë të gjitha procedurat e nevojshme për të siguruar përmbushjen efektive të kërkesave të parashikuara në pikën 2 të këtij neni.
2. Shtëpia e klerimit/CCP që paraqet kërkesën duhet:
 - a) Të paraqesë rregullore në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 195, pika 5 të Ligjit;
 - b) Të veprojë në çdo kohë në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 15 deri në 20 të kësaj Rregulloreje, si dhe me nenin 197 të Ligjit;
 - c) Të miratojë rregullore dhe procedura për të siguruar përmbushjen e kësaj rregulloreje, përfshi përmbushjen nga ana e drejtuesve dhe punonjësve të saj të të gjitha dispozitave të kësaj rregulloreje.
3. Subjekti që paraqet kërkesën për të vepruar si CCP duhet të përmbushë kërkesat organizative dhe operative të përcaktuara në nenet 21 deri në 49 të kësaj rregulloreje.

Neni 8

Procedura e paraqitjes së kërkesës

Kërkesa për licencë për krijimin dhe/ose operimin e një shtëpie klerimi mund të paraqitet vetëm nga një person juridik.

Subjekti kërkues paraqet kërkesën për licencë për krijimin dhe/ose operimin e një shtëpie klerimi ose për të vepruar si CCP në përputhje me legjislacionin në fuqi, ligjin nr. 133, datë 29.04.2013 “Për sistemin e pagesave” dhe Ligjin.

Subjekti kërkues vërteton përmbushjen e kërkesave të parashikuara në nenin 195, pika 5 dhe 197 të Ligjit, si dhe kërkesat specifike të kësaj rregulloreje, duke siguruar të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm bashkë me kërkesën.

Subjekti kërkues që paraqet kërkesë për të vepruar si CCP paraqet dokumentacion dhe informacion shtesë lidhur me përmbushjen e kërkesave të posaçme për CCP-të.

Subjekti kërkues i paraqet Autoritetit, për miratim, kërkesën që shoqëron informacionin dhe dokumentet në përputhje me nenet 9 deri 11 të kësaj rregulloreje.

Neni 9

Përmbajtja e kërkesës

1. Subjekti kërkues paraqet dokumentacionin në vijim lidhur me:
 - a) Të dhënat e shoqërisë sipas ligjit nr. 9901 “Për shoqëritë tregtare”, kryesisht:
 - (i) kopje të aktit të themelimit dhe statutin;

- (ii) kopje të NIPT.
 - b) Listën e aksionarëve dhe organit drejtues, që përbëhet nga persona të aftë dhe të përshtatshëm, në përputhje me nenin 13 të Ligjit;
 - b/1) Informacionin në lidhje me strukturën e pronësisë dhe aksionarët e subjektit, si më poshtë:
 - (i) Të dhëna mbi strukturën e kapitalit të personit juridik deri në aksionarin e fundit;
 - (ii) Të dhënat e parashikuara në pikën (i), plotësohen edhe nga aksionarët e aksionarit person juridik, që zotërojnë mbi 25% të aksioneve me të drejtë vote.
 - c) Të dhëna mbi qeverisjen e shoqërisë;
 - d) Rregullore të klerimit, politikave, procedurave dhe kontratave të subjektit kërkues, që përmbajnë dispozita në përputhje me nenin 195, pika 5 të Ligjit;
 - e) Marrëveshjet për mbledhjen dhe administrimin e kolateralit të mbajtur për performancën e detyrimeve të anëtarëve të klerimit ose klientëve të anëtarëve të klerimit;
 - f) Krijimin dhe operimin e faciliteteve të mjaftueshme për trajtimin e titujve dhe instrumenteve financiare, si dhe transaksioneve;
 - g) Mjedise të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit të saj, si:
 - (i) marrëveshje për një infrastrukturë efektive dhe të besueshme për lehtësimin e klerimit të titujve dhe instrumenteve financiare nga subjekti kërkues;
 - (ii) personel kompetent për zhvillimin e aktivitetit të subjektit, dhe
 - (iii) sisteme automatike me kapacitetet dhe facilitetet e duhura, rregulla sigurie dhe mbështetje teknike për përballimin e të papriturave ose katastrofave, të miratuara nga Autoriteti;
 - (iv) rregullat dhe procedurat për monitorimin e transaksioneve.
 - h) Klasat e instrumenteve financiare që mund të klerohen në sistemet e subjektit;
 - i) Listën e anëtarëve të klerimit të subjektit kërkues;
 - j) Rregullat e miratuara për të siguruar integritetin e tregut dhe anëtarëve të saj të klerimit;
 - k) Rregullat dhe procedurat e subjektit kërkues, që siguron përmbushjen e kërkesave të parashikuara në nenin 197, nga pika 1 deri 5 të Ligjit.
2. Nëse subjekti kërkues paraqet kërkesë për të operuar një shtëpi klerimi, me shërbime klerimi si CCP, paraqet kërkesën në përputhje me pikën 1 të këtij neni, si dhe dokumentacionin e nevojshëm lidhur me përmbushjen e neneve 21 deri në 49 të kësaj rregulloreje, sidomos:
- a) Kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 21 të kësaj rregulloreje;

- b) Përbushjen e kërkesave të kapitalit, në përputhje me nenin 22 të kësaj rregulloreje dhe të dhëna mbi rregullat ekzistuese për mbajtjen e kapitalit fillestar sipas përcaktimeve, duke përfshirë një rezervë të përshtatshme;
 - c) Rregullat ekzistuese për menaxhimin e rreziqeve të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e subjektit kërkues;
 - d) Sistemi i marzhit, që përcakton nivelet e marzhit në raport të drejtë me rreziqet dhe karakteristikat e veçanta të çdo produkti, portofoli dhe tregu të cilit i shërben;
 - e) Rregullat për ngritjen dhe mbajtjen e një fondi për mospërbushje, për të zbutur rrezikun, në rast se ka mospërbushje nga një anëtar klerimi dhe për të siguruar, përbushjen e detyrimeve të këtij anëtari klerimi, kur është e mundur;
 - f) Një regjim i përshtatshëm i segregimit dhe mundësisë së lëvizshmërisë për të mbrojtur pozitat e klientëve të një anëtari klerimi, mospërbushjen dhe infrastrukturën, burimet dhe drejtimin e nevojshëm për të lehtësuar funksionet e saj të menaxhimit pas tregtimit dhe, në rast mospërbushjeje prej një ose më shumë anëtarëve të klerimit:
 - (i) të sigurohet se ka politika, procedura dhe procese të mjaftueshme të miratuara dhe
 - (ii) ka kontrole të brendshme të shëndetshme për përpunimin dhe menaxhimin e duhur të transaksioneve.
 - g) Rregulla ekzistuese për procedurat e sigurisë dhe back-up, për të siguruar paprekshmërinë e të dhënave të transaksioneve të kleruara, të shlyera ose të kleruara dhe të shlyera përmes CCP-së dhe ruajtjen e të dhënave;
3. Subjekti kërkues njofton pa vonesë Autoritetin për çdo ndryshim të rëndësishëm që ndikon në kushtet e licencës.

Neni 10

Forma e kërkesës

1. Subjekti kërkues duhet t'i paraqesë Autoritetit kërkesën me shkrim duke përdorur formë- kërkesën sipas Shtojcës I të kësaj rregulloreje dhe informacionin e parashikuar në nenin 9 të kësaj rregulloreje, me referenca të qarta në informacionet e paraqitura sipas përcaktimeve në Shtojcën I.
2. Kur paraqet informacionin e kërkuar, subjekti kërkues:
 - a) Sigurohet që informacioni i paraqitur të identifikojë qartë kërkesat specifike të Ligjit dhe rregullores të cilave u referohet dhe dokumentin ku jepet ky informacion;
 - b) Sigurohet që nëse një kërkesë e Ligjit apo e rregullores nuk gjen zbatim, të paraqitet ky fakt së bashku me një shpjegim;
 - c) Paraqet informacionin sipas renditjes në rubrikën 3 të referencës së dokumenteve të formë- kërkesës, sipas Shtojcës I.

3. Subjekti kërkues me vendndodhje në Republikën e Shqipërisë, paraqet çdo informacion të kërkuar në gjuhën shqipe.
4. Subjekti kërkues me vendndodhje jashtë Republikës së Shqipërisë, paraqet çdo informacion që kërkohet edhe të përkthyer në gjuhën shqipe.
5. Subjekti kërkues paraqet me shkrim dokumentet e nevojshme për kërkesën.

Neni 11 Refuzimi

Në përputhje me nenin 196 të Ligjit, Autoriteti nuk miraton dhënien e licencës nëse nuk bindet që subjekti kërkues përmbush të gjitha kërkesat e parashikuara në nenin 7 të kësaj rregulloreje dhe dispozitat e neneve 195 dhe 197 të Ligjit.

Autoriteti nuk e licencon shtëpinë e klerimit/CCP nëse nuk ka informacion për identitetet e aksionarëve ose të anëtarëve, qofshin ata persona fizikë ose juridikë që kanë drejtpërdrejtë ose tërthorazi pjesëmarrje influencuese dhe për vlerat e këtyre pjesëmarrjeve.

Në rastet kur ekzistojnë lidhje të ngushta midis shtëpisë së klerimit/CCP dhe personave të tjerë fizikë ose juridikë, Autoriteti e jep licencën vetëm kur këto lidhje nuk pengojnë ushtrimin efektiv të funksioneve mbikëqyrëse të Autoritetit.

Kur personat e përmendur në pikën 2 të këtij neni ushtrojnë një ndikim që ka gjasë të pengojë menaxhimin e shëndoshë e të kujdesshëm të shtëpisë së klerimit/CCP, Autoriteti merr masat e duhura, në përputhje me nenin 12 të kësaj Rregulloreje, për t'i dhënë fund kësaj situatë, që mund të përfshijë tërheqjen e licencës të shtëpisë së klerimit/CCP.

Autoriteti refuzon licencën kur ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative të një vendi të huaj që ka nën juridiksion një ose më shumë persona fizikë ose juridikë me të cilët shtëpia e klerimit/CCP ka lidhje të ngushta, pengojnë ose vështirësojnë ushtrimin efektiv të funksioneve mbikëqyrëse të Autoritetit.

Neni 12 Heqja e licencës dhe pasojat e heqjes

Në përputhje me nenin 198 të Ligjit dhe duke marrë në konsideratë interesat dhe mbrojtjen e investitorëve dhe interesin publik për rregullimin e duhur të tregut, Autoriteti mund:

- a) T'i anulojë dhe t'i heqë licencën që i është dhënë shtëpisë së klerimit/CCP, ose
- b) Të urdhërojë shtëpinë e klerimit/CCP të ndalë ofrimin e shërbimeve të caktuara ose operimin e sistemeve të caktuara, të specifikuara nga Autoriteti.

Autoriteti mund ta kufizojë heqjen e licencës te një shërbim, veprimtari ose klasë ose instrumente financiare të caktuara, sipas specifikimit në njoftimin përkatës.

Masat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni vendosen me anë të njoftimit me shkrim. Vendimi për heqjen e licencës hyn në fuqi në datën e caktuar në njoftim.

Autoriteti merr këto masa në rast se:

- a) Shtëpia e klerimit/CCP ndërpret ofrimin e shërbimeve të klerimit në përputhje me nenin 198, pika 3 të Ligjit, veçanërisht kur shtëpia e klerimit heq dorë shprehimisht nga licenca apo nuk ka ofruar asnjë shërbim ose nuk ka kryer asnjë veprimtari gjatë 28 ditëve paraardhëse, duke përjashtuar rastin kur pushimi është miratuar paraprakisht nga Autoriteti;
- b) Shtëpia e klerimit/CCP ka shkelur kushtet e licencës ose këtë Rregullore, ose vendimet e nxjerra nga Autoriteti;
- c) Shtëpia e klerimit/CCP nuk i përmbush më kushtet në bazë të të cilave i është lëshuar licenca dhe nuk ka ndërmarrë veprimet korrigjuese të kërkuara nga Autoriteti brenda një afati të caktuar;
- d) Shtëpia e klerimit/CCP nuk ka përmbushur asnjë urdhër që është nxjerrë në përputhje me këtë Rregullore ose me Ligjin, ose me çdo rregull në fuqi;
- e) Shtëpia e klerimit/CCP e ka përfituar licencën duke bërë deklaramë të rreme ose çorientuese ose përmes mënyrave të parregullta;
- f) Shtëpia e klerimit/CCP ka shkelur rëndë dhe sistematikisht ndonjë prej kërkesave të parashikuara në këtë rregullore;
- g) Një vendim për shlyerje borxhi kundër shtëpisë së klerimit/CCP nuk është shlyer plotësisht ose pjesërisht;
- h) Shtëpia e klerimit/CCP është në procedurë likuidimi, në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj;
- i) Në lidhje me ndonjë pasuri të shtëpisë së klerimit/CCP është emëruar një administrator falimentimi ose një likuidues në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj;
- j) Shtëpia e klerimit/CCP ka lidhur një marrëveshje kompromisi me kreditorët e saj (në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj);
- k) Shtëpia e klerimit/CCP me nismën e saj, i ka kërkuar Autoritetit heqjen e licencës dhe Autoriteti e ka miratuar këtë kërkesë.

Pavarësisht nga heqja e licencës ose nga urdhri i dhënë, Autoriteti mund t'i lejojë shtëpisë së klerimit/CCP të vazhdojë të ushtrojë, në datën e hyrjes në fuqi të heqjes ose pas saj, ato veprimtari të prekura nga heqja ose urdhrat, të cilat mund të përcaktohen nga Autoriteti në funksion të:

- a) Mbylljes së veprimtarisë së shtëpisë së klerimit/CCP ose pushimit të ofrimit të shërbimeve të përcaktuara në njoftim;
- b) Mbrojtjes së investitorëve ose interesit publik.

Në rast se Autoriteti ka marrë një masë në zbatim të pikës 1 të këtij neni, Autoriteti mund të emërojë, nëse është e nevojshme, një Këshill të Përkohshëm Administrimi për një periudhë

gjashtëmujore për të administruar aktivitetin e shtëpisë së klerimit/CCP deri në emërimin e një këshilli të ri. Mandati i Këshillit të Përkohshëm të Administrimit mund të zgjatet deri në një vit.

Autoriteti nuk duhet të ndër marrë veprime në bazë të pikës 1 të këtij neni, pa i dhënë mundësi më parë shtëpisë së klerimit/CCP të shprehet me shkrim.

Shtëpia e klerimit ose CCP e cila çënohet nga një vendim i Autoritetit, mund të bëjë ankim në gjykatë.

Autoriteti publikon çdo vendim për heqje licence, ose çdo urdhër të lëshuar në zbatim të këtij neni.

Neni 13 **Shqyrtimi nga Autoriteti**

Subjekti kërkues paraqet të gjitha informacionet e nevojshme në bazë të të cilave Autoriteti mund të vlerësojë nëse, në momentin e licencimit, subjekti kërkues ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të përmbushur kërkesat e parashikuara në këtë rregullore dhe ato të parashikuara në Ligj.

Autoriteti mund të miratojë licencën duke vendosur kushtet dhe kriteret që çmon të arsyeshme, me kusht që subjekti kërkues të ketë depozituar të gjitha dokumentet e nevojshme.

Brenda 30 ditëve pune nga marrja e kërkesës, Autoriteti vlerëson nëse kërkesa është e plotë. Nëse kërkesa nuk është e plotë, Autoriteti cakton një afat brenda të cilit subjekti kërkues duhet të paraqesë informacione shtesë. Pasi të vlerësojë që kërkesa është e plotë, Autoriteti njofton për këtë subjektin kërkues.

Autoriteti njofton subjektin kërkues mbi vendimin lidhur me miratimin e kërkesës brenda 60 ditëve pune nga paraqitja e dokumentacionit të plotë.

Në rast se Autoriteti nuk merr një vendim për kërkesën brenda afateve të parashikuara në pikën 4 të këtij neni, mosmarrja e vendimit nuk konsiderohet si miratim i kërkesës.

Në rast se Autoriteti çmon se kërkesa nuk i përmbush standardet e plotësisë dhe nuk provon përmbushjen në bazë të nenit 7, pikat 2 dhe 3 të kësaj Rregulloreje dhe/ose nëse konstatohen mangësi ose parregullsi dhe/ose nevojiten ndryshime ose informacione shtesë:

- a) Njofton subjektin kërkues rreth faktit me shkrim ose elektronikisht menjëherë ose brenda afateve të caktuara në pikën 1 të këtij neni, të llogaritura nga momenti i dorëzimit të kërkesës dhe
- b) specifikon qartë ndryshimet dhe informacionet shtesë të nevojshme.

Në këto raste, afati i përcaktuar në pikën 4 të këtij neni nis nga data në të cilën depozitohet kërkesa e rishikuar tek Autoriteti.

Autoriteti, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga personat e përcaktuar në këtë rregullore, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të OKB-së dhe të BE-së, njoftimet e OKB-së, si dhe listat e Integruara të Personave të shpallur.

Neni 14 **Shqyrtimi dhe vlerësimi**

Autoriteti shqyrton masat, strategjitë, proceset dhe mekanizmat e zbatuara nga subjekti kërkuar për të vepruar në përputhje me këtë rregullore dhe vlerëson rreziqet, veçanërisht rreziqet financiare dhe operative, ndaj të cilave janë ose mund të jenë të ekspozuara shtëpitë e klerimit ose CCP-të.

Shqyrtimi dhe vlerësimi përfshin të gjitha kërkesat e parashikuara në këtë rregullore.

Autoriteti vendos shpeshtësinë dhe shkallën e shqyrtimit dhe vlerësimit duke marrë parasysh veçanërisht madhësinë, rëndësinë sistemike, natyrën, shkallën, kompleksitetin e aktiviteteve dhe ndërlidhjen me infrastruktura të tjera të tregut financiar të shtëpive të klerimit/CCP-ve. Shqyrtimi dhe vlerësimi përditësohen të paktën çdo vit.

Shtëpitë e klerimit dhe CCP-të u nënshtrohen kontrolleve në terren.

Autoriteti i kërkon çdo shtëpie klerimi ose CCP-je që nuk përmbush kërkesat e parashikuara në këtë Rregullore të ndërmarrë masat ose hapat e nevojshme në një fazë të hershme për të zgjidhur situatën.

KREU IV **KËRKESAT OPERATIVE DHE ORGANIZATIVE PËR SHTËPITË E KLERIMIT**

Neni 15 **Rregullat për mospërmbushjen**

Me qëllim administrimin e rrezikut, shtëpia e klerimit mund të nisë procedurat e mospërmbushjes në bazë të rregulloreve të saj, nëse një anëtar klerimi nuk është në gjendje ose mund të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet në lidhje me ndonjë apo të gjitha kontratat e pashlyera të tregut, palë e së cilës/ave është anëtari i klerimit.

Në këtë rast zbatohen rregullat e procedurave të mospërmbushjes sipas neneve 201 deri në 203 të Ligjit.

Neni 16 **Padia civile**

Pavarësisht nga ndonjë dispozitë e ndonjë ligji tjetër, kur instrumentet financiare i dorëzohen shtëpisë së klerimit për shlyerjen e një kontrate tregu ose jepen si kolateral financiar, ose në bazë të një marrëveshjeje kolaterali financiar, nga një anëtar klerimi në përputhje me rregulloret e shtëpisë së klerimit, kundër shtëpisë së klerimit nuk mund të ngrihet apo të lejohet asnjë pretendim në lidhje me ndonjë të drejtë, titull ose interes për instrumentet financiare të dorëzuara shtëpisë së klerimit.

Neni 17

Dispozitat për marrëveshjen e kolateralit financiar dhe ekzekutimi i tyre

Shtëpia e klerimit pranon kolateral me risk minimal tregu dhe krediti për të mbuluar ekspozimin e saj fillestar e në vazhdim ndaj anëtarëve të saj të klerimit.

Shtëpia e klerimit mund të pranojë, kur është e e përshtatshme dhe prudencialisht e mjaftueshme, aktivin bazë të kontratës derivative ose instrumentin financiar prej nga vjen ekspozimi i shtëpisë së klerimit, si kolateral për të mbuluar kërkesat e saj të marzhit.

Në përputhje me nenin 206 dhe 207 të Ligjit, shtëpia e klerimit duhet të ketë të drejtë të ekzekutojë kolateralin në bazë të një marrëveshjeje të kolateralit financiar, në përputhje me procedurën e përcaktuar në rregulloren e shtëpisë së klerimit.

Kur një pasuri është objekt i një marrëveshjeje kolaterali financiar ose është vendosur si kolateral financiar, shitja e kësaj pasurie nga shtëpia e klerimit nuk mund të pengohet nga asnjë proces tjetër ligjor përmbarimi apo urdhër ekzekutimi dhe kjo pasuri nuk mund të përdoret për asnjë shlyerje tjetër nga personi përgjegjës, që kërkon ekzekutimin e interesave apo garancive të vendosura mbi pasurinë, me përjashtim të rastit kur kjo miratohet nga shtëpia e klerimit, pavarësisht nga parashikimet e ligjeve të tjera.

Neni 18

Rregullat për investime

Shtëpitë e klerimit mund t'i investojnë burimet e tyre financiare vetëm në mjete monetare ose instrumente financiare me rrezik minimal tregu dhe krediti.

Shtëpia e klerimit mund të udhëzojë shoqërinë komisionere (brokerin) që të kryejë në emër të shtëpisë së klerimit një shitje ose blerje të instrumenteve financiare nëse një shitje apo blerje e tillë, sipas rastit, kryhet në funksion të shlyerjes së një kontrate tregu ose në kuadër të një procedure mospërmbushjeje ose për t'i dhënë mundësi shtëpisë së klerimit të ekzekutojë një aktiv të përfshirë në një marrëveshje kolaterali financiar ose të vendosur si kolateral financiar. Bursa duhet ta zbatojë këtë udhëzim.

Kur shitja ose blerja e instrumenteve financiare bëhet në emër të shtëpisë së klerimit nga shoqëria komisionere (brokeri) në përputhje me pikën 2 të këtij neni, ndërmjetësi nuk mund të ngrejë padi ndaj asnjë personi dhe ndërmjetësi nuk mban përgjegjësi ndaj askujt.

Neni 19

Transferimi i instrumenteve financiare në shlyerje

Përveç rregullave të përcaktuara në nenin 208 të Ligjit, instrumentet financiare të shpallura si marzhe ose kontribute për fondin e mospërmbushjes depozitohen, kur janë të vlefshme, nga operatorët e sistemeve të shlyerjes së titujve, që sigurojnë mbrojtjen e plotë të këtyre instrumenteve financiare. Si alternativë, mund të përdoren marrëveshje të tjera shumë të sigurta me institucionet financiare të autorizuara.

Neni 20

Imuniteti nga përgjegjësia civile dhe penale

1. Sipas parashikimeve të nenit 210 të Ligjit, nuk mund të jenë objekti i një përgjegjësie civile ose penale:
 - a) Personi që përmbush një detyrim në bazë të delegimit, sipas rregulloreve të mospërmbushjes së shtëpisë të klerimit në lidhje me ndonjë procedurë mospërmbushjeje ose
 - b) Çdo person që vepron në emër të personit të përmendur në shkronjën a), duke përfshirë:
 - i. çdo anëtar të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës të personit të përmendur në shkronjën a) dhe
 - ii. çdo anëtar të çdo komiteti të ngritur nga personi i përmendur në shkronjën a) për çdo veprim (përfshirë deklarata të dhëna) ose mosveprim në mirëbesim gjatë përmbushjes së këtij detyrimi, ose në lidhje me përmbushjen faktike ose të synuar të këtij detyrimi.
2. Kur personi përgjegjës ndërmerr veprime në lidhje me pasurinë e një personi, që është në mospërmbushje, në bazë të rregulloreve të mospërmbushjes së shtëpisë së klerimit dhe në mënyrë të arsyeshme beson se ai ka të drejtë ta kryejë këtë veprim, personi përgjegjës nuk mban përgjegjësi për humbjet ose dëmtimet që rezultojnë nga një veprim i tillë, përveçse kur humbja ose dëmtimi është shkaktuar nga pakujdesia e personit përgjegjës.

KREU V

KËRKESAT E POSAÇME OPERATIVE DHE ORGANIZATIVE PËR CCP-të

Neni 21

Kërkesa të përgjithshme

1. CCP-ja ka rregulla të forta qeverisjeje, që përfshijnë një strukturë të qartë organizative me linja përgjegjësie të mirëpërcaktuara, transparente dhe të qëndrueshme, procese efektive për të identifikuar, menaxhuar, monitoruar dhe raportuar rreziqet ndaj të cilave është apo mund të jetë e ekspozuar, si dhe mekanizma të mjaftueshëm të kontrollit të brendshëm, përfshi procedura të shëndosha administrative dhe kontabiliteti.
2. CCP-ja miraton rregulla dhe procedura që janë mjaftueshëm efektive për të siguruar përputhshmërinë me këtë rregullore, përfshi përputhshmërinë e drejtuesve dhe punonjësve të saj me të gjitha dispozitat e kësaj rregulloreje.
3. CCP-ja ngre dhe vë në funksionim një strukturë organizative që siguron vazhdimësinë dhe funksionimin e rregullt të shërbimeve dhe veprimtarive të saj. Ajo përdor sisteme, burime dhe procedura të përshtatshme dhe proporcionale për këtë qëllim.

4. CCP-ja miraton zbaton dhe mirëmban një politikë shpërblimi, e cila promovon menaxhimin e shëndoshë dhe efektiv të rrezikut dhe që nuk krijon stimuj për lehtësimin e standardeve të rrezikut.
5. CCP-ja përdor sisteme të teknologjisë së informacionit të përshtatshme për të përballuar kompleksitetin, larminë dhe llojet e veprimtarive të kryera për të siguruar standarde të larta sigurie dhe integritetin e fshehtësinë e informacionit të ruajtur.
6. CCP-ja i bën publike pa pagesë masat e administrimit të brendshëm, rregullat që qeverisin CCP-në dhe kriteret e saj të pranimit për anëtarët e klerimit.
7. CCP-ja u nënshtrohet auditimeve të shpeshta dhe të pavarura. Rezultatet e këtyre auditimeve i komunikohen Këshillit të Administrimit/Këshillit të Mbikëqyrës dhe i vihen në dispozicion Autoritetit.

Neni 22

Kërkesat e kapitalit

1. Kapitali fillesatar minimal i CCP-së është 500 milion lekë.
2. Kapitali i CCP-së përfshirë fitimet e pashpërndara dhe rezervat mund të rritet në proporcion me rrezikun që lind nga aktivitetet e CCP-së.
3. Kapitali duhet të jetë i mjaftueshëm në çdo kohë për të siguruar një mbyllje të rregullt ose ristrukturim të aktiviteteve brenda një periudhe të përshtatshme, dhe një mbrojtje të mjaftueshme për CCP-në kundrejt rreziqeve të kreditit, kundërpalës, tregut dhe atyre operative ligjore e tregtare, që nuk mbulohen tashmë nga burime specifike financiare, parashikuar nga nenet 39 deri në 44 të kësaj rregulloreje.

Neni 23

Aksesi në CCP

1. CCP-ja e licencuar për klerimin e transaksioneve, në përputhje me nenin 194, pika, 2 të Ligjit dhe nenin 6 të kësaj rregulloreje, pranon klerimin e këtyre transaksioneve pa asnjë dallim dhe në mënyrë transparente, përfshi kërkesat e kolateralit dhe tarifatat që lidhen me aksesin, pavarësisht platformës së tregtimit. Në veçanti, ajo siguron që platforma e tregtimit të ketë të drejtën e trajtimit jo diskriminues sa i takon mënyrës sesi trajtohen kontratat e tregtuara në këtë platformë tregtimi lidhur me:
 - a) Kërkesat e kolateralit dhe netimit të kontratave të barasvlefshme ekonomikisht, kur përfshirja e këtyre kontratave në procedurat e shitjes dhe procedura të tjera netimi të CCP-së, bazuar në legjislacionin në fuqi për falimentin, nuk rrezikojnë funksionimin e rregullt e pa pengesa, vlefshmërinë dhe ekzekutueshmërinë e këtyre procedurave dhe
 - b) kompensimin e marzheve me kontrata të ndërlidhura të kleruara nga e njëjta CCP, bazuar në një model rreziku që është në përputhje me nenin 40 të kësaj rregulloreje.

2. CCP-ja mund t'u kërkojë platformave të tregtimit të veprojnë në përputhje me kërkesat operative dhe teknike të përcaktuara nga CCP-ja, përfshi kërkesat e administrimit të rrezikut.
3. CCP-ja pranon ose refuzon kërkesën për akses nga një platformë tregtimi brenda tre muajsh nga kjo kërkesë.
4. Në rast refuzimi të aksesit në zbatim të pikës 3 të këtij neni, CCP-ja i paraqet platformës së tregtimit arsyet e plota të këtij refuzimi.
5. Me përjashtim të rastit kur autoriteti kompetent mbikëqyrës i platformës së tregtimit dhe ai i CCP-së refuzojnë aksesin, CCP-ja, i jep akses platformës së tregtimit brenda tre muajve nga vendimi i pranimit të kërkesës zyrtare në përputhje me pikën 2 të këtij neni.
6. Autoriteti mbikëqyrës i platformës së tregtimit dhe ai i CCP-së mund të refuzojnë aksesin në CCP pas kërkesës zyrtare të platformës së tregtimit, vetëm kur ky akses do të kërcënonte funksionimin e rregullt dhe pa pengesa të tregjeve ose do të ndikonte negativisht rrezikun sistemik.

Neni 24

Aksesi në platformat e tregtimit

1. Platforma e tregtimit ofron informacione mbi tregtimin pa asnjë dallim dhe në mënyrë transparente për çdo CCP që është autorizuar për klerimin e transaksioneve të tregtuara në këtë platformë tregtimi, me kërkesë të CCP-së. Kur CCP-ja i paraqet platformës së tregtimit një kërkesë zyrtare për akses, platforma e tregtimit i përgjigjet CCP-së brenda tre muajve.
2. Kur platforma e tregtimit e refuzon aksesin, ajo e njofton për këtë CCP-në, duke i dhënë arsyet e plota.
3. Pa paragjykuar vendimin nga autoritetet kompetente të platformës së tregtimit dhe të CCP-së, platforma e tregtimit mundëson aksesin brenda tre muajve nga përgjigjja pozitive ndaj kërkesës për akses.
4. CCP-së i jepet akses në platformën e tregtimit vetëm kur ky akses nuk kërkon ndërveprim apo nuk kërcënon funksionimin e rregullt e pa pengesa të tregjeve, sidomos për shkak të fragmentarizimit të likuiditetit, ndërsa platforma e tregtimit ka krijuar mekanizmat e duhur për parandalimin e këtij fragmentarizimi.

Neni 25

Drejtuesit e lartë dhe Këshilli

1. Administratori dhe funksionarët kryesorë të CCP-së duhet të gëzojnë emër të mirë dhe të zotërojnë përvojë të mjaftueshme për të garantuar një administrim të shëndoshë e të kujdesshëm të CCP-së.
2. Organi drejtues i CCP-ja është Këshilli. Një e treta, por jo më pak sesa dy, e anëtarëve të Këshillit duhet jenë të pavarur. Për çështje që lidhen me nenet 37 dhe 38 të kësaj

rregulloreje në mbledhjen e Këshillit ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësuesit e klientëve të anëtarëve të klerimit.

3. Anëtarët e Këshillit të CCP-së, përfshi anëtarët e tij të pavarur, duhet të gëzojnë emër të mirë dhe të zotërojnë përvojë të mjaftueshme në shërbimet financiare, menaxhimin e rrezikut dhe shërbimet e klerimit.
4. CCP-ja përcakton qartë rolet dhe përgjegjësitë e Këshillit dhe i vendos në dispozicion Autoritetit dhe audituesve procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit.

Neni 26 **Komiteti i Riskut**

1. CCP-ja ngre një Komitet për Riskun, që përbëhet nga përfaqësues të anëtarëve të saj të klerimit, anëtarë të pavarur të Këshillit dhe përfaqësues të klientëve të saj. Komiteti i Riskut mund të ftojë punonjësit e CCP-së dhe ekspertë të jashtëm të pavarur të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit të Riskut pa të drejtë vote. Autoriteti mund të kërkojë të marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit të Riskut pa të drejtë vote dhe të informohet si duhet rreth veprimtarive dhe vendimeve të komitetit të riskut. Këshillat e Komitetit të Riskut është e pavarur nga çdo ndikim i drejtuesve të CCP-së. Asnjë nga grupet e përfaqësuesve nuk ka shumicën në Komitetin e Riskut.
2. CCP-ja përcakton qartë mandatin, rregullat e drejtimit të brendshëm, që sigurojnë pavarësinë, procedurat operative, kriteret e pranimi dhe mekanizmin zgjedhor për anëtarët e Komitetit të Riskut. Rregullat e drejtimit bëhet publike dhe përcaktojnë, të paktën, se Komiteti i Riskut drejtohet nga një anëtar i pavarur i Këshillit, i raporton drejtpërdrejtë Këshillit dhe zhvillon mbledhje të rregullta.
3. Komiteti i riskut këshillon dhe i rekomandon Këshillit çdo masë që mund të ndikojë në administrimin e riskut të CCP-së, si një ndryshim i rëndësishëm në modelin e saj të riskut, në procedurat e mospërmbushjes, kriteret e pranimi të anëtarëve të klerimit, klerimin e klasave të reja të instrumenteve ose delegimin e funksioneve. Këshillimi nga Komiteti i Riskut nuk kërkohet për veprimtaritë e përditshme të CCP-së. Këshilli mund të këshillohet me Komitetin e Riskut mbi zhvillimet që kanë ndikim mbi administrimin e riskut të CCP-së në situata emergjence.
4. Anëtarët e Komitetit të Riskut janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin. Kur kryetari i Komitetit të Riskut vendos se një anëtar ka një konflikt faktik ose të mundshëm interesi për një çështje të caktuar, ky anëtar nuk do të lejohet të votojë për këtë çështje.
5. CCP-ja njofton menjëherë Autoritetin për çdo vendim të Këshillit për të mos ndjekur këshillën e Komitetit të Riskut.

Neni 27 **Mbajtja e regjistrave**

1. CCP-ja mban për një periudhë prej të paktën 10 vjetësh të gjitha të dhënat mbi shërbimet dhe aktivitetin e ofruar për t'i dhënë mundësi Autoritetit të monitorojë respektimin e Rregullores nga CCP-ja.

2. CCP-ja mban për një periudhë prej të paktën 10 vjetësh pas përfundimit të një kontrate, të gjithë informacionin mbi të gjitha kontratat që ka përpunuar. Ky informacion mundëson identifikimin e kushteve fillestare të transaksionit përpara klerimit nga kjo CCP.
3. Kur kërkohet, CCP-ja i vendos në dispozicion Autoritetit regjistrat dhe informacionet që disponon dhe të gjitha të dhënat mbi pozicionet e kontratave të kleruara, pavarësisht platformës ku janë ekzekutuar transaksionet.

Neni 28

Aksionarët dhe anëtarët me pjesëmarrje influencuese

1. Autoriteti nuk e licencën CCP-në pa u informuar më parë për identitetin e aksionarëve ose anëtarëve të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që janë persona fizikë ose juridikë, të cilët kanë pjesëmarrje influencuese dhe për vlerat e këtyre pjesëmarrjeve.
2. Autoriteti refuzon të licencojë CCP-në nëse nuk është i bindur për përshtatshmërinë e aksionarëve ose anëtarëve që zotërojnë pjesëmarrje influencuese në CCP.
3. Kur ekziston një lidhje e ngushtë midis CCP-së dhe personave të tjerë fizikë ose juridikë, Autoriteti e jep licencën vetëm kur këto lidhje nuk pengojnë ushtrimin efektiv të funksioneve mbikëqyrëse të Autoritetit.
4. Kur personat e përmendur në pikën 1 të këtij neni ushtrojnë një ndikim që mund të pengojë administrimin shëndetshëm dhe të kujdesshëm të CCP-së, Autoriteti merr masat e duhura për zgjidhjen e kësaj situate, që mund të përfshijë heqjen e licencës së CCP-së.
5. Autoriteti refuzon licencën kur ligjet, rregullat ose dispozitat administrative të një vendi të huaj që qeverisin një ose më shumë persona fizikë ose juridikë me të cilët CCP-ja ka lidhje të ngushta pengojnë ose vështirësojnë ushtrimin efektiv të funksioneve mbikëqyrëse të Autoritetit.

Neni 29

Informimi i Autoritetit

1. CCP-ja njofton Autoritetin për çdo ndryshim të drejtuesve të saj dhe i jep Autoritetit të gjitha informacionet e nevojshme për të vlerësuar përputhshmërinë me nenin 25, pika 1 të kësaj rregulloreje.
2. Kur sjellja e një anëtari të Këshillit mund të jetë paragjyqese ndaj administrimit të shëndetshëm dhe të kujdesshëm të CCP-së, Autoriteti merr masat e duhura, që mund të përfshijnë edhe largimin nga Këshilli të këtij anëtari.
3. Çdo person fizik ose juridik, ose personat që veprojnë në bashkëpunim ('blerësi i propozuar'), që kanë vendosur të blejnë drejtpërdrejtë apo tërthorazi pjesëmarrje influencuese në një CCP ose të rritin më tej, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, këtë pjesëmarrje influencuese në një CCP, si rezultat i së cilës raporti i të drejtave të votimit ose i kapitalit të zotëruar do të arrinte ose do të tejkalonte 10 %, 20 %, 30 % ose 50 %, apo do të bënte që CCP-ja të bëhej shoqëri e kontrolluar prej tyre ('blerja e propozuar'),

do të njoftojnë së pari me shkrim Autoritetin, se po kërkojnë të blejnë ose të shtojnë pjesëmarrjen influencuese, duke përshkruar masën e pjesëmarrjes së synuar dhe informacionin përkatës, sipas përcaktimit në nenin 25, pika 4 të kësaj rregulloreje.

4. Çdo person fizik ose juridik i cili ka vendosur të shesë drejtpërdrejtë ose tërthorazi pjesëmarrjen influencuese në një CCP ('shitësi i propozuar') njofton së pari me shkrim Autoritetin, duke përshkruar madhësinë e kësaj pjesëmarrjeje. Ky person e njofton gjithashtu Autoritetin kur merr vendim për zvogëlimin e pjesëmarrjes influencuese në atë pikë që raporti i të drejtave të votimit ose të kapitalit ulet nën 10 %, 20 %, 30 % ose 50 %, apo që bën që CCP-ja të mos jetë më shoqëri e kontrolluar e këtij personi.
5. Autoriteti i dërgon menjëherë dhe, në çdo rast, brenda dy ditëve pune nga marrja e njoftimit dhe të informacioneve të përmendura në pikën 3 të këtij neni, konfirmim me shkrim për marrjen e njoftimit, blerësit ose shitësit të propozuar.
6. Autoriteti bën vlerësimin brenda 60 ditëve pune, nga data e konfirmimit me shkrim të marrjes së njoftimit dhe të gjitha dokumenteve që shoqërojnë njoftimin.
7. Në momentin e konfirmimit të marrjes në dorëzim, Autoriteti informon blerësin ose shitësin e propozuar për datën e përfundimit të afatit të vlerësimit.
8. Nëse është e nevojshme, Autoriteti mund të kërkojë gjatë periudhës së vlerësimit, por jo më vonë sesa dita e pesëdhjetë e periudhës së vlerësimit, informacione shtesë që nevojiten për përfundimin e vlerësimit. Kjo kërkesë paraqitet me shkrim dhe përcakton informacionin e nevojshëm shtesë.
9. Periudha e vlerësimit ndërpritet nga data e paraqitjes së kërkesës për informacion nga Autoriteti dhe marrjes së përgjigjes nga blerësi i propozuar. Kjo ndërprerje nuk zgjat më shumë se 20 ditë pune. Çdo kërkesë e mëtejshme e Autoritetit për plotësimin apo sqarimin e informacionit është në kompetencë të tij, por mund të mos sjellë si rezultat një ndërprerje të periudhës së vlerësimit.
10. Autoriteti mund të zgjasë ndërprerjen e periudhës së vlerësimit deri në 30 ditë pune, kur shitësi ose blerësi i propozuar e ka vendndodhjen ose vepron në bazë të rregullave jashtë Republikës së Shqipërisë.
11. Nëse Autoriteti, pas përfundimit të vlerësimit, vendos të kundërshtojë blerjen e propozuar, ai njofton me shkrim blerësin e propozuar brenda dy ditëve pune, pa e tejkalluar afatin e vlerësimit dhe jep arsyet për këtë vendim.
12. Nëse Autoriteti nuk e kundërshton blerjen e propozuar brenda periudhës së vlerësimit, ajo konsiderohet e miratuar.
13. Autoriteti mund të caktojë një afat maksimal për kryerjen e blerjes së propozuar dhe ta shtyjë atë, kur është e nevojshme.
14. Subjektet sipas kësaj rregulloreje, kanë detyrimin të garantojnë përmbushjen e vazhdueshme të kritereve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga individët që mbajnë pozicionet përkatëse. Vlerësimi i këtyre kritereve duhet të kryhet rregullisht, të paktën një herë në vit, si dhe në çdo rast kur ndodhin ndryshime të rëndësishme në rrethanat që mund të ndikojnë në profilin e individit. Subjektet depozitojnë në Autoritet çdo vit,

brenda muajit mars të vitit pasardhës vetëdeklarimet përkatëse të çdo individi mbi vijueshmërinë e përmbushjes së kritereve.

Neni 30 **Vlerësimi**

1. Kur vlerëson njoftimin dhe informacionin e parashikuar në nenin 29, pika 2 të kësaj rregulloreje, Autoriteti, për të garantuar menaxhimin e shëndetshëm dhe të kujdesshëm të CCP-së në të cilin propozohet blerja dhe duke mbajtur parasysh ndikimin e mundshëm të blerësit të propozuar mbi CCP-në, vlerëson përshtatshmërinë e këtij të fundit dhe aftësinë financiare të blerjes së propozuar, përkundrejt sa vijon:
 - a) Emrin dhe aftësinë financiare të blerësit të propozuar;
 - b) Emrin dhe përvojën e personit që do të drejtojë aktivitetin e CCP-së si rezultat i blerjes së propozuar;
 - c) Nëse CCP-ja do të mund të përmbushë dhe të vazhdojë të përmbushë kërkesat e kësaj rregulloreje;
 - d) Nëse ka shkaqe të arsyeshme për të dyshuar se, lidhur me blerjen e propozuar, është kryer, po kryhet ose po bëhen përpjekje për kryerjen e pastrimit të parave ose financimit terrorist ose se blerja e propozuar mund të rrisë rrezikun në këtë drejtim.
2. Kur vlerëson aftësinë financiare të blerësit të propozuar, Autoriteti i kushton vëmendje të posaçme llojit të aktivitetit që zhvillohet dhe parashikohet në CCP-në ku propozohet blerja.
3. Kur vlerëson aftësinë e CCP-së për të vepruar në përputhje me këtë rregullore, Autoriteti i kushton vëmendje të veçantë faktit nëse grupi pjesë e të cilit do të bëhet ka një strukturë që mundëson ushtrimin e mbikëqyrjes efektive, për shkëmbimin efektiv të informacionit midis autoriteteve kompetente dhe për të përcaktuar ndarjen e përgjegjësive midis autoriteteve kompetente, kur është nevoja.
4. Autoriteti mund të kundërshtojë blerjen e propozuar vetëm kur ka shkaqe të arsyeshme, ose kur informacioni i paraqitur nga blerësi i propozuar është i paplotë.
5. Autoriteti publikon një listë që përcakton informacionet e nevojshme për kryerjen e vlerësimit dhe ua dërgon atë autoriteteve të tjera të huaja, nëse është nevoja, në momentin e njoftimit të përmendur në nenin 29, pika 2 të kësaj Rregulloreje. Informacioni i kërkuar është proporcional dhe i përshtatet natyrës së blerësit të propozuar dhe blerjes së propozuar.
6. Kur Autoriteti ka marrë njoftim për dy ose më shumë propozime për blerjen ose rritjen e pjesëmarrjeve influencuese në të njëjtën CCP, ai i trajton blerësit e propozuar në mënyrë jo diskriminuese.
7. Nëse është e nevojshme, Autoriteti bashkëpunon me autoritete të tjera kompetente, kur kryen vlerësimin në të cilin blerësi i propozuar është një prej:

- a) Një tjetër CCP, institucion krediti, shoqëri sigurimi, shoqëri sigurimesh, shoqëri risigurimi, shoqëri komisionere, operator tregu, operator i një sistemi për shlyerjen e titujve, një shoqëri administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive në tituj të transferueshëm (SIKTT) ose një administrues i fondit të investimeve alternative (AFIA) të licencuar jashtë Republikës së Shqipërisë;
 - b) Shoqëri mëmë e një CCP-je tjetër, institucioni krediti, shoqërie sigurimi, shoqërie sigurimesh, shoqërie risigurimi, shoqërie komisionere, operatori tregu, operatori të një sistemi për shlyerjen e titujve, një shoqërie administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive në tituj të transferueshëm (SIKTT) ose një administruesi të fondit të investimeve alternative (AFIA) të licencuar jashtë Republikës së Shqipërisë;
 - c) Një person fizik ose juridik që kontrollon një tjetër CCP, institucion krediti, shoqëri sigurimi, shoqëri sigurimesh, shoqëri risigurimi, shoqëri komisionere, operator tregu, operator i një sistemi për shlyerjen e titujve, një shoqëri administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive në tituj të transferueshëm (SIKTT) ose një administrues i fondit të investimeve alternative (AFIA) të licencuar jashtë Republikës së Shqipërisë;
8. Autoriteti dhe autoritetet kompetente shkëmbejnë mes njëri-tjetrit, pa asnjë vonesë, informacione thelbësore që mbartin rëndësi për vlerësimin. Autoriteti dhe autoritetet kompetente i komunikojnë njëri-tjetrit të gjithë informacionin përkatës, kur kërkohet dhe komunikojnë të gjithë informacionin thelbësor me iniciativën e tyre. Vendimi nga autoriteti kompetent që ka licencuar CCP-në ku propozohet blerja informon për pikëpamjet ose rezervat e shprehura nga autoriteti kompetent përgjegjës për blerësin e propozuar.

Neni 31 **Konflikti i interesit**

1. CCP-ja miraton dhe zbaton rregulla të shkruara efektive, organizative dhe administrative, për të identifikuar dhe menaxhuar konfliktet e mundshme të interesit midis saj, përfshi drejtuesit, punonjësit e saj ose çdo person me kontroll të drejtpërdrejtë ose të tërthortë apo me lidhje të ngushta dhe anëtarëve të saj të klerimit ose klientëve të tyre të njohur për CCP-në. Ajo miraton dhe zbaton procedura të përshtatshme që synojnë të zgjidhin konfliktet e mundshme të interesit.
2. Kur rregullat organizative ose administrative të CCP-së për menaxhimin e konfliktit të interesit nuk janë të mjaftueshme për të siguruar, me bindje të arsyeshme, parandalimin e rreziqeve që dëmtojnë interesat e anëtarëve të klerimit ose klientit, ajo iu bën qartësisht me dije natyrën e përgjithshme ose burimet e konflikteve të interesit të anëtarit të klerimit, përpara se të pranojë transaksione të reja nga ky anëtar klerimi. Kur klienti është i njohur për CCP-në, CCP-ja informon klientin dhe anëtarin e klerimit klienti i të cilit është i përfshirë.
3. Kur CCP-ja është shoqëri mëmë ose shoqëri e kontrolluar, rregullat e shkruara marrin në konsideratë çdo rrethanë për të cilën CCP-ja është ose duhet të jetë në dijeni, që mund të çojë në konflikt interesi dhe që lind si rezultat i strukturës dhe aktivitetit tregtar të shoqërive të tjera me të cilat ka një marrëdhënie si shoqëri mëmë apo shoqëri e kontrolluar.

4. Rregullat e shkruara përfshijnë:
 - a) Rrethanat që përbëjnë ose mund të sjellin një konflikt interesi i cili përfshin një rrezik të rëndësishëm për dëmtimin e interesave të një ose më shumë anëtarëve të klerimit ose klientëve;
 - b) Procedurat që duhen ndjekur dhe masat që duhen miratuar për të menaxhuar këtë konflikt.
5. CCP-ja merr të gjitha masat e arsyeshme për të parandaluar keqpërdorimin e informacionit që ruhet në sistemet e saj dhe parandalon përdorimin e këtij informacioni për aktivitete të tjera tregtare. Personi fizik që ka një lidhje të ngushtë me një CCP ose personi juridik që ka një marrëdhënie si shoqëri mëmë ose e kontrolluar me një CCP nuk përdor informacion konfidencial të regjistruar në atë CCP për qëllime tregtare, pa miratimin paraprak të klientit të cilit i përket ky informacion konfidencial.

Neni 32 Vazhdimësia e aktivitetit

1. CCP-ja harton, zbaton dhe mban një politikë të përshtatshme për vazhdimësinë e aktivitetit dhe një plan rimëkëmbjeje nga katastrofat, që synojnë ruajtjen e funksioneve të saj, rimëkëmbjen në kohë të veprimtarive dhe përmbushjen e detyrimeve të CCP-së. Ky plan mundëson, të paktën, rikuperimin e të gjitha transaksioneve në momentin e ndërprerjes, për ta lejuar CCP-në të vijojë veprimtarinë e sigurt dhe të kryejë shlyerjet në datën e programuar.
2. CCP-ja harton, zbaton dhe mban një procedurë të përshtatshme, që siguron shlyerjen ose transferimin e rregullt dhe në kohë të aktiveve dhe pozicioneve të klientëve dhe të anëtarëve të klerimit, në rast heqjeje të licencës, në bazë të nenit 12 të kësaj rregulloreje.

Neni 33 Delegimi

1. Kur CCP-ja delegon detyrat operative, shërbimet ose aktivitetet, ajo mban përgjegjësi të plotë për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të saj në bazë të kësaj rregulloreje dhe sigurohet në çdo kohë që:
 - a) Delegimi të mos sjellë si rezultat delegimin e përgjegjësive të saj;
 - b) Raporti dhe detyrimet e CCP-së kundrejt anëtarëve të klerimit ose, kur është rasti, kundrejt klientëve të tyre, të mos ndryshojnë;
 - c) Kushtet e licencimit të CCP-së efektimisht nuk ndryshojnë;
 - d) Delegimi nuk pengon ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse dhe kontrolluese, përfshi aksesin në vend për marrjen e informacioneve përkatëse të nevojshme për përmbushjen e këtyre funksioneve;
 - e) Delegimi nuk sjell si rezultat privimin e CCP-së nga sistemet dhe kontrollet e nevojshme për të menaxhuar rreziqet me të cilat përballet;

- f) Ofruesi i shërbimeve zbaton kritere të njëjta të vazhdimësisë së aktivitetit me ato që duhet të përmbushë CCP-ja në bazë të kësaj rregulloreje;
 - g) CCP-ja ruan ekspertizën dhe burimet e nevojshme për të vlerësuar cilësinë e shërbimeve të ofruara, aftësinë e mjaftueshme organizative dhe të kapitalit të ofruesit të shërbimit, mbikëqyrjen efektive të funksioneve të deleguara, menaxhimin e rreziqeve që shoqërojnë delegimin dhe mbikëqyrjen e këtyre funksioneve, duke i menaxhuar këto rreziqe në mënyrë të vazhdueshme;
 - h) CCP-ja ka akses të drejtpërdrejtë në informacionet e funksioneve të deleguara;
 - i) Ofruesi i shërbimit bashkëpunon me autoritetin kompetent lidhur me veprimtaritë e deleguara;
 - j) Ofruesi i shërbimeve mbron çdo informacion konfidencial që lidhet me CCP-në dhe anëtarët e saj të klerimit dhe klientët ose, kur ofruesi i shërbimit është themeluar në një vend të huaj, ai sigurohet që standardet e mbrojtjes së të dhënave të atij vendi të huaj ose ato që përcaktohen në marrëveshje midis palëve të interesuara, janë të krahasueshme me standardet e mbrojtjes së të dhënave në fuqi në Bashkimin Evropian.
2. CCP-ja nuk delegon veprimtari kryesore që lidhen me menaxhimin e riskut, përveçse kur ky delegim miratohet nga Autoriteti.
 3. Autoriteti i kërkon CCP-së të ndajë dhe të përcaktojë qartë në një marrëveshje me shkrim të drejtat dhe detyrimet e saj dhe ato të ofruesit të shërbimit.
 4. CCP-ja vë në dispozicion, kur kërkohet, të gjithë informacionin e nevojshëm që i jep mundësi Autoritetit të vlerësojë përputhshmërinë e kryerjes së veprimtarive të deleguara me këtë Rregullore.

KREU VI RREGULLAT E ZHVILLIMIT TË AKTIVITETIT PËR CCP-të

Neni 34 Dispozita të përgjithshme

1. CCP-ja vepron drejtë e me profesionalizëm në ofrimin e shërbimeve të saj anëtarëve të klerimit dhe kur është rasti, klientëve të tyre, në përputhje me interesat më të mira të anëtarëve të klerimit dhe klientëve dhe me menaxhimin e kujdeshëm të riskut.
2. CCP-ja ka rregulla të aksesueshme, transparente dhe të drejta për zgjidhjen e menjëhershme të ankesave.
3. CCP-ja i ofron informacione mbi transaksionet, pa dallim dhe me transparencë, Depozitarit Qendror të Titujve (DQT). Kur kërkohet nga DQT-ja, CCP-ja mund t'i vendosë DQT-së një tarifë të arsyeshme tregtare për këto informacione mbi transaksionet, si kosto shtesë, përveçse kur është rënë dakord ndryshe nga të dyja palët.

Neni 35

Kërkesat e pjesëmarrjes

1. Kur është e nevojshme, CCP-ja përcakton, sipas llojit të produktit të kleruar, kategoritë e anëtarëve të klerimit që pranohen dhe kriteret e pranimit, pas këshillimit më parë me Komitetin e Riskut, në bazë të nenit 26, pika 3 të kësaj rregulloreje. Këto kriteret janë jodiskriminuese, transparente dhe objektive, dhe kanë si qëllim aksesin e drejtë dhe të hapur në CCP dhe sigurojnë që anëtarët e klerimit të kenë burime të mjaftueshme financiare dhe kapacitet operativ për të përmbushur detyrimet që lindin nga pjesëmarrja në CCP. Kriteret që kufizojnë aksesin lejohen deri në pikën ku objektivi i tyre është të kontrollojnë riskun për CCP-në.
2. CCP-ja sigurohet që kriteret e përmendura më sipër të zbatohen në vazhdimësi dhe ka akses në kohë në informacionin e nevojshëm për këtë vlerësim. CCP-ja kryen një kontroll të gjithanshëm, së paku njëherë në vit, të përmbushjes së këtij neni nga anëtarët e saj të klerimit.
3. Anëtarët e klerimit që klerojnë transaksione për llogari të klientëve të tyre kanë burimet e nevojshme financiare dhe kapacitetin operativ për kryerjen e këtij aktiviteti. Rregullat e CCP-së për anëtarët e klerimit i japin asaj mundësi të mbledhë të dhënat e nevojshme bazë për të identifikuar, monitoruar dhe menaxhuar përqendrimet përkatëse të rrezikut që lidhen me ofrimin e shërbimeve për klientët. Kur kërkohet, anëtarët e klerimit informojnë CCP-në mbi kriteret dhe marrëveshjet që miratojnë për t'iu lejuar klientëve të tyre qasje në shërbimet e CCP-së. Anëtarët e klerimit kanë përgjegjësi për të siguruar që klientët përmbushin detyrimet e tyre.
4. CCP-ja ka procedura objektive dhe transparente për pezullimin dhe largimin e anëtarëve të klerimit që nuk përmbushin më kriteret e pranimit.
5. CCP-ja mund t'ua mohojë aksesin anëtarëve të klerimit që përmbushin kriteret e përmendura në pikën 1 të këtij neni, kur e justifikon konform rregullave me shkrim dhe bazuar në një analizë të gjithanshme rreziku.
6. CCP-ja mund të vendosë detyrime të posaçme shtesë për anëtarët e klerimit, si pjesëmarrja në ankandet të anëtarit me pozicione mospërmbushëse të klerimit. Këto detyrime shtesë janë në raport të drejtë me rrezikun që ka shkaktuar anëtari i klerimit dhe nuk e kufizon pjesëmarrjen në kategori të caktuara të anëtarëve të klerimit.

Neni 36

Transparenca

1. CCP-ja dhe anëtarët e saj të klerimit bëjnë publike çmimet dhe tarifatat që shoqërojnë shërbimet e ofruara. Ata shpallin çmimet dhe tarifatat e çdo shërbimi të ofruar më vete, duke përfshirë zbritjet dhe rimbursimet, si dhe kushtet për të përfituar nga këto ulje. CCP-ja u jep anëtarëve të saj të klerimit dhe, kur është rasti, klientëve të tyre, të drejta të veçanta për përdorimin e shërbimeve specifike që ofrohen.
2. CCP-ja kontabilizon më vete kostot dhe të ardhurat e shërbimeve të ofruara dhe ia jep këtë informacion autoritetit.

3. CCP-ja informon anëtarët e klerimit dhe klientët për rreziqet që lidhen me shërbimet e ofruara.
4. CCP-ja njofton anëtarët e klerimit dhe Autoritetin mbi informacionet e çmimit të përdorura për të përlllogaritur ekspozimet e saj ndaj anëtarëve të saj të klerimit në përfundim të ditës së tregtimit.
5. CCP-ja informon publikisht rreth volumeve të transaksioneve të kleruara për çdo klasë instrumentesh, të kleruar mbi baza agregate.
6. CCP-ja bën publike kërkesat operative dhe teknike që lidhen me protokollet e komunikimit që mbulojnë përmbajtjen dhe formatet e mesazheve që përdor për të ndërvepruar me palët e treta.
7. CCP-ja bën publike çdo shkelje nga anëtarët e klerimit të kritereve të përmendura në nenin 35, pika 1 të kësaj rregulloreje dhe kërkesave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, me përjashtim të rastit kur autoriteti kompetent, pas këshillimit me Autoritetin, vlerëson se ky publikim do të përbënte kërcënim për stabilitetin financiar ose për besimin e tregut ose do të rrezikonte rëndë tregjet financiare apo do t'u shkaktonte dëme shpërpjesëtimore palëve të përfshira.
8. CCP-ja u ofron anëtarëve të saj të klerimit një mjet simulimi, që u jep mundësi të përcaktojnë vlerën e marzhit fillestar shtesë si vlerë bruto, të cilën CCP-ja mund ta kërkojë pas klerimit të një transaksioni të ri. Ky instrument përdoret vetëm mbi bazën e aksesit të sigurt dhe rezultatet e tij nuk janë të detyrueshme.
9. CCP-ja u ofron anëtarëve të saj të klerimit informacion mbi modelet e marzhit fillestar që përdor. Ky informacion:
 - a) Shpjegon qartë konceptin e modelit të marzhit fillestar dhe mënyrën e funksionimit të tij;
 - b) Përshkruan qartë supozimet kyçe dhe kufizimet e modelit të marzhit fillestar dhe rrethanat në të cilat këto supozime nuk janë më të vlefshme;
 - c) Është i dokumentuar.

Neni 37

Segregimi dhe transferueshmëria

1. CCP-ja i mban të ndara të dhënat dhe llogaritë, që i japin mundësinë të dallojë pa vonesë dhe në çdo kohë, në llogaritë me CCP-në, aktivet dhe pozicionet e mbajtura për një nga anëtarët e klerimit nga aktivet dhe pozicionet e mbajtura për llogari të anëtarëve të tjerë të klerimit dhe nga aktivet e veta.
2. CCP-ja mban të ndara të dhënat dhe llogaritë duke bërë të mundur që çdo anëtar klerimi të dallojë në llogaritë me CCP-në aktivet dhe pozicionet e këtij anëtari klerimi nga ato që mbahen për llogari të klientëve të tij ('ndarja e klientëve omnibus').
3. CCP-ja mban të ndara të dhënat dhe llogaritë, në mënyrë që t'i mundësojë çdo anëtar klerimi të dallojë aktivet dhe pozicionet e mbajtura për llogari të një klienti, nga ato të

mbajtura për llogari të klientëve të tjerë ('ndarje si klient individual'). Kur kërkohet, CCP-ja iu ofron anëtarëve të klerimit mundësinë për të hapur më shumë llogari në emrin e tyre për llogari të klientëve të tyre.

4. Anëtari i klerimit i mban të ndara të dhënat dhe llogaritë në mënyrë që si në llogaritë e mbajtura me CCP-në, ashtu edhe në llogaritë e tij, aktivet dhe pozicionet e tij të dallojnë nga aktivet dhe pozicionet e mbajtura për llogari të klientëve të tij në CCP.
5. Anëtari i klerimit u ofron klientëve të tij të paktën zgjedhjen midis "ndarjes me klientë omnibus" dhe "ndarjes si klient individual" dhe i informon ata lidhur me kostot dhe nivelin e mbrojtjes së përmendur në pikën 7 të këtij neni. Klienti e konfirmon zgjedhjen e tij me shkrim.
6. Kur klienti zgjedh ndarjen si klient individual, çdo marzh që tejkalon kërkesat e klientit do t'i njoftohet CCP-së dhe do të veçohet nga marzhet e klientëve të tjerë ose anëtarëve të klerimit dhe nuk do të ekspozohet ndaj humbjeve që lidhen me pozicionet e regjistruara në një llogari tjetër.
7. CCP-ja dhe anëtarët e klerimit bëjnë publike nivelet e mbrojtjes dhe kostot që shoqërojnë nivelet e ndryshme të ndarjes dhe i ofrojnë këto shërbime në bazë të kushteve të arsyeshme tregtare. Detajet e niveleve të ndryshme të ndarjes përfshijnë përshkrimin e efekteve kryesore juridike të niveleve përkatëse të ndarjes së ofruar, përfshi informacione mbi ligjin për falimentin.
8. CCP-ja ka të drejtën e përdorimit lidhur me marzhet ose kontributet e fondit të mospërbushjes të grumbulluara përmes marrëveshjes së kolateralit financiar të titujve, me kusht që kjo marrëveshje të parashikohet në kushtet e saj të punës. Anëtari i klerimit konfirmon pranimin e kushteve të punës me shkrim. CCP-ja shpall publikisht të drejtën e përdorimit.
9. Kërkesa për dallimin e aktiveve dhe pozicioneve me CCP-në në llogari përmbushet kur:
 - a) Aktivet dhe pozicionet regjistrohen në llogari të ndara;
 - b) Parandalohet regjistrimi i pozicioneve neto në llogari të ndryshme;
 - c) Aktivet që mbulojnë pozicionet e regjistruara në një llogari nuk janë të ekspozuara ndaj humbjeve që lidhen me pozicionet e regjistruara në një llogari tjetër.
10. Aktivet i referohen kolateralit të mbajtur për të mbuluar pozicionet dhe përfshijnë të drejtën për të transferuar aktivet e barasvlerëshme me këtë kolateral ose të ardhurat nga ekzekutimi i kolateralit, por nuk përfshijnë fondin e kontributeve të mospërbushjes.

KREU VII

KËRKESAT PRUDENCIALE PËR CCP-të

Neni 38

Menaxhimi i ekspozimit

CCP-ja mat dhe vlerëson likuiditetin dhe ekspozimet ndaj kreditit të çdo anëtari klerimi dhe, kur është rasti, të një tjetër CCP-je me të cilën ka lidhur marrëveshje ndërveprimi, thuajse në kohë reale. CCP-ja ka akses në kohë dhe pa asnjë dallim në burimet përkatëse të çmimeve për të matur efektivisht ekspozimet e saj. Kjo bëhet bazuar në një kosto të arsyeshme.

Neni 39

Kërkesat e marzheve

1. CCP-ja vendos, kërkon dhe mbledh marzhe për të kufizuar ekspozimet e kreditit nga anëtarët e saj të klerimit dhe kur është rasti, nga CCP-të me të cilat ka marrëveshje ndërveprimi. Këto marzhe janë të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimet e mundshme që CCP-ja vlerëson se mund të ndodhin deri në likuidimin e pozicioneve përkatëse.

Gjithashtu, ato do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar humbjet që vijnë nga të paktën 99 % e ngjarjeve ekspozuese gjatë një afati të përshtatshëm kohor dhe do të sigurohen që CCP-ja të kolateralizojë plotësisht ekspozimet e saj me të gjithë anëtarët e saj të klerimit dhe, kur është rasti, me CCP-të me të cilat ka lidhur marrëveshje ndërveprimi, të paktën çdo ditë.

CCP-ja monitoron rregullisht dhe, kur është nevoja, rishikon nivelin e marzheve të saj për të pasqyruar kushtet aktuale të tregut, duke marrë parasysh çdo efekt prociklik të këtyre rishikimeve.

2. CCP-ja miraton modelet dhe parametrat për përcaktimin e kërkesave të saj për marzhet që përmbajnë karakteristikat e rrezikut të produkteve të kleruara, duke marrë parasysh intervalin midis mbledhjes së marzhit, likuiditetit të tregut dhe mundësisë së ndryshimeve përgjatë kohës së transaksionit. Modelet dhe parametrat konfirmohen nga Autoriteti.
3. CCP-ja mbledh marzhet brenda ditës, të paktën kur janë tejkaluar kufijtë e paracaktuar.
4. CCP-ja kërkon dhe mbledh marzhet që janë të mjaftueshme për të mbuluar rrezikun që lind nga pozicionet e regjistruara në secilën prej llogarive të mbajtura. CCP-ja mund të përlllogaritë marzhet lidhur me një portofol instrumentesh financiare, me kusht që metodika të jetë e konsoliduar dhe e kujdesshme.
5. Për të siguruar zbatimin e këtij neni, Autoriteti harton projektstandarde rregullatore teknike që përcaktojnë përqindjen e duhur dhe afatet kohore për periudhën e likuidimit dhe përlllogaritjen e paqëndrueshmërisë historike, të cilat duhen marrë në konsideratë për klasa të ndryshme të instrumenteve financiare, duke mbajtur parasysh objektivin për të kufizuar prociklizmin dhe kushtet në bazë të të cilave mund të zbatohen praktikat e vendosjes së marzheve të portofolit.

Neni 40

Fondi i mospërmbushjes

1. Për të kufizuar më tej ekspozimet e kreditit ndaj anëtarëve të saj të klerimit, CCP-ja krijon një fond mospërmbushjeje me parafinancim, për të mbuluar humbjet që i tejkalojnë kostot që mbulohen nga kërkesat e marzhit, të parashikuara në nenin 39 të kësaj rregulloreje, të cilat lindin nga mospërmbushja, duke përfshirë nisjen e një procedure falimenti, nga një ose më shumë anëtarë të klerimit.
2. CCP-ja përcakton një vlerë minimale nën të cilën nuk duhet në asnjë rrethanë të bjerë shuma e fondit të mospërmbushjes.
3. CCP-ja cakton vlerën minimale të kontributeve për fondin e mospërmbushjes dhe kriteret e përlllogaritjes së kontributeve të secilit prej anëtarëve të klerimit. Kontributet janë në raport të drejtë me ekspozimet e çdo anëtari të klerimit.
4. Fondi i mospërmbushjen do t'i japë CCP-së mundësinë që nën kushte ekstreme por të mundshme të tregut, të përballojë mospërmbushjen e anëtarit të klerimit ndaj të cilit ka ekspozimet më të mëdha ose të anëtarit të dytë ose të tretë më të madh të klerimit, nëse shuma e ekspozimeve të tyre është më e madhe. CCP-ja harton skenarë të kushteve ekstreme por të mundshme të tregut. Skenarët përfshijnë periudhat më të paqëndrueshme që kanë përjetuar tregjet për të cilat CCP-ja ofron shërbimet e saj dhe një gamë skenarësh të mundshëm për të ardhmen. Ata marrin parasysh shitjet e papritura të burimeve financiare dhe uljet e menjëhershme në likuiditet në treg.
5. CCP-ja mund të krijojë më shumë sesa një fond mospërmbushjeje për klasa të ndryshme të instrumenteve që kleron.

Neni 41

Kontrollet e rrezikut të likuiditetit

6. CCP-ja ka në çdo kohë likuiditet të mjaftueshëm për kryerjen e shërbimeve dhe aktiviteteve të saj. Për këtë qëllim, ajo përfton linjat e nevojshme të kredisë apo marrëveshje të ngjashme për të mbuluar nevojat e saj për likuiditet, në rast se burimet financiare që ka në dispozicion nuk janë të mjaftueshme. Një anëtar klerimi, shoqëri mëmë ose shoqëri e kontrolluar e këtij anëtari klerimi nuk sigurojnë së bashku më shumë se 25 % të linjës së kredisë për të cilën ka nevojë CCP-ja.
7. CCP-ja llogarit çdo ditë nevojat e saj të mundshme për likuiditet. Ajo merr parasysh rrezikun e likuiditetit që vjen nga mospërmbushja e të paktën dy anëtarëve të klerimit ndaj të cilëve ka ekspozimet më të mëdha.
8. Për të siguruar zbatimin e këtij neni, Autoriteti harton projektstandarde rregullatore teknike që përcaktojnë kuadrin për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit që CCP-të duhet të përballojnë.

Neni 42

Modeli Waterfall i mospërmbushjes

1. CCP-ja përdor marzhet e shpallura nga anëtari mospërmbushës i klerimit për të mbuluar humbjet, përpara burimeve të tjera financiare.
2. Kur marzhet e shpallura nga anëtari mospërmbushës i klerimit nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar humbjet që i shkaktohen CCP-së, CCP-ja përdor kontributin e fondit të mospërmbushjes së anëtarit mospërmbushës për t'i mbuluar këto humbje.
3. CCP-ja përdor kontributet e fondit të mospërmbushjes të anëtarëve mospërmbushës të klerimit dhe çdo burim tjetër financiar të përmendur në nenin 43, pika 1 të kësaj rregulloreje vetëm pasi ka shteruar kontributet e anëtarit mospërmbushës të klerimit.
4. CCP-ja përdor burimet e veta të dedikuara përpara se të përdorë kontributet e fondit të mospërmbushjes të anëtarëve mospërmbushës të klerimit. CCP-ja nuk i përdor marzhet e shpallura nga anëtarët e klerimit që nuk janë mospërmbushës për të mbuluar humbjet që vijnë si rezultat i mospërmbushjes së anëtarëve të tjerë të klerimit.
5. Për të siguruar zbatimin e këtij neni, Autoriteti harton projektstandarde rregullatore teknike që përcaktojnë metodikën e përlogaritjes dhe mbajtjes së pjesës së burimeve të veta të CCP-së, që do të përdoret në përputhje me pikën 4 të këtij neni.

Neni 43

Kërkesat për kolateralin

1. CCP-ja pranon kolateral shumë likuid me rrezik minimal krediti dhe tregu për të mbuluar ekspozimin e saj fillestar dhe në vazhdim ndaj anëtarëve të saj të klerimit. Për kundërpalët jofinanciare, CCP-ja mund të pranojë garanci bankare, duke i marrë parasysh këto garanci kur llogarit ekspozimin e saj ndaj një banke që është anëtar klerimi. Ajo aplikon marzhet përkatëse reduktuese të vlerave të aktiveve, që pasqyrojnë mundësinë që vlerat e tyre të ulen brenda intervalit midis rivlerësimit të tyre të fundit dhe kohës në të cilën mund të supozohet në mënyrë të arsyeshme se do të likuidohen. Ajo merr parasysh rrezikun e likuiditetit si rezultat i mospërmbushjes së një pjesëmarrësi në treg dhe rrezikun e përqendrimit të disa aktiveve që mund të rezultojnë nga përcaktimi i kolateralit të pranueshëm dhe marzheve përkatëse reduktuese.
2. Për të mbuluar kërkesat e saj të marzheve, CCP-ja mund të pranojë si kolateral, kur është e përshtatshme dhe prudente, vlerën bazë të kontratës derivative ose instrumentit financiar ku e ka filluesën ekspozimi i CCP-së.
3. Për të siguruar zbatimin e këtij neni, Autoriteti harton projektstandarde rregullatore teknike që përcaktojnë:
 - a) Llojin e kolateralit që mund të konsiderohet shumë likuid, si mjetet monetare, ari, obligacione qeveritare dhe të shoqërive aksionare me vlerësim të lartë dhe obligacionet e garantuara me kolateral (*covered bonds*);
 - b) Marzhet reduktuese dhe
 - c) kushtet në të cilat garancitë e bankave tregtare mund të pranohen si kolateral.

Neni 44

Politika e investimit

1. CCP-ja i investon burimet e saj financiare vetëm në mjete monetare ose instrumente financiare me likuiditet të lartë, me risk minimal tregu dhe krediti. Investimet e CCP-së mund të likuidohen shpejt me efekte minimale negative mbi çmimin.
2. Vlera e kapitalit, përfshi fitimin e pashpërndarë dhe rezervat e CCP-së që nuk janë investuar sipas pikës 1 të këtij neni, nuk merren parasysh për qëllimet e nenit 22, pika 2 ose të nenit 42, pika 4 të kësaj rregulloreje.
3. Instrumentet financiare të publikuara si marzhe ose si kontribute për fondin e mospërbushjes depozitohen, kur janë të vlefshme, me operatorë të sistemeve të shlyerjes së titujve që sigurojnë mbrojtje të plotë të këtyre instrumenteve financiare.

Si alternativë, mund të përdoren marrëveshje të tjera që kanë siguri të lartë me institucionet e autorizuara financiare.

4. Depozitimet e mjeteve monetare të CCP-së bëhen përmes sistemeve të sigurisë së lartë me institucione financiare të autorizuara ose, përndryshe, përmes përdorimit të lehtësirave të përhershme të depozitave të bankave qendrore ose mjeteve të tjera të ngjashme që ofrohen nga bankat qendrore.
5. Kur CCP-ja i depoziton asetet te një palë e tretë, ajo sigurohet që aktivet që u përkasin anëtarëve të klerimit të identifikohen më vete nga aktivet që i përkasin CCP-së dhe aktivet që u përkasin palëve të treta përmes llogarive me emërtime të ndryshme në regjistrat e palës së tretë ose masa të tjera të barasvlefshme që arrijnë të njëjtin nivel mbrojtjeje. CCP-ja ka akses të menjëhershëm në instrumentet financiare, kur është nevoja.
6. CCP-ja nuk e investon kapitalin e saj ose shumat që vijnë nga kërkesat e parashikuara në nenet 39, 40, 41 ose 42 të kësaj rregulloreje në titujt e saj apo ato të shoqërive të saj mëmë ose shoqërive të kontrolluara.
7. CCP-ja merr parasysh ekspozimin e saj të përgjithshëm të riskut të kreditit ndaj debitorëve, kur merr vendimet për të investuar dhe sigurohet që ekspozimi i përgjithshëm i riskut ndaj çdo debitori individual mbetet brenda kufijve të pranueshëm të përqendrimit.
8. Për të siguruar zbatimin e këtij neni, Autoriteti harton projektstandarde rregullatore teknike, që përcaktojnë instrumentet financiare që mund të konsiderohen me likuiditet të lartë, që bartin risk minimal krediti dhe tregu, masat e sigurisë së lartë dhe kufijtë e përqendrimit.

Neni 45

Procedurat e mospërbushjes

1. CCP-ja parashikon procedura të detajuara për t'u zbatuar kur një anëtar klerimi nuk vepron në përputhje me kriteret e pjesëmarrjes të CCP-së, të përcaktuara në nenin 35 të kësaj rregulloreje, brenda afatit dhe sipas procedurave të përcaktuara nga, CCP-ja.

CCP-ja parashikon me hollësi procedurat që duhen ndjekur në rast se mospërbushja e një anëtari të klerimit nuk deklarohet nga CCP-ja. Këto procedura rishikohen çdo vit.

2. CCP-ja merr masa të menjëhershme për të kufizuar humbjet dhe presionin mbi likuiditetin, që vijnë si rezultat i mospërbushjes dhe sigurohet që shitja e pozicioneve të çdo anëtari klerimi të mos ndërpresë veprimtaritë e saj ose të ekspozojë anëtarët e klerimit që nuk janë mospërbushës ndaj humbjeve që ata nuk mund t'i parashikojnë ose t'i kontrollojnë.
3. Kur CCP-ja vlerëson se anëtari i klerimit nuk do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e ardhshme, ajo informon menjëherë autoritetin kompetent përpara se të deklarohet apo të zbatohet procedura e mospërbushjes.
4. CCP-ja verifikon nëse procedurat e saj të mospërbushjes janë të zbatueshme. Ajo merr masa të arsyeshme për t'u siguruar se ka kompetencat ligjore për likuidimin e pozicioneve pronësore të anëtarit mospërbushës dhe për transferimin ose likuidimin e pozicioneve të klientëve të anëtarit mospërbushës të klerimit.
5. Kur aktivet dhe pozicionet regjistrohen në regjistrat dhe llogaritë e CCP-së si të mbajtura në emër të klientëve të anëtarit mospërbushës të klerimit, në përputhje me nenin 37, pika 2 të kësaj rregulloreje, CCP-ja angazhohet, të paktën në bazë të një kontrate, që të nisë procedurat e transferimit të aktiveve dhe pozicioneve që zotërohen nga anëtari mospërbushës i klerimit për llogari të klientëve të tij drejt një tjetër anëtari klerimi të emëruar nga të gjithë këta klientë, me kërkesën e tyre dhe pa miratimin e anëtarit mospërbushës të klerimit. Anëtari tjetër i klerimit është i detyruar t'i pranojë këto aktive dhe pozicione vetëm nëse ka lidhur më parë marrëdhënie kontraktuale me klientët për të cilët është angazhuar për ta bërë këtë. Nëse transferimi të anëtarit tjetër i klerimit nuk është kryer për një arsye çfarëdo brenda afatit të paracaktuar të transferimit, i specifikuar në rregullat e tij të funksionimit, CCP-ja mund të marrë masat që lejon rregullorja e saj për të menaxhuar risqet në lidhje me këto pozicione, përfshi likuidimin e aktiveve dhe pozicioneve që zotëron anëtari mospërbushës i klerimit për llogari të klientëve të tij.
6. Kolaterali i klientëve i përcaktuar në përputhje me nenin 37, pikat 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje, përdoret vetëm për të mbuluar pozicionet e mbajtura për llogari të tyre. Çdo vlerë e mbetur pa paguar nga CCP-ja pas përfundimit të procesit të menaxhimit të mospërbushjes së anëtarit të klerimit nga CCP-ja u kthehet menjëherë këtyre klientëve, kur janë të njohur për CCP-në ose, nëse nuk janë, anëtarit të klerimit për llogari të klientëve të tij.
7. CCP-të hartojnë procedura që i lejojnë të pezullojnë, në konsultim me autoritetet e tyre përkatëse kompetente, çdo pjesëmarrës që në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike nuk dorëzon instrumentet financiare në datën e vendosur të shlyerjes si dhe të bëjë publik identitetin e tij vetëm pasi i ka dhënë këtij pjesëmarrësi mundësinë të paraqesë vërejtjet e tij dhe me kusht që autoritetet kompetente të CCP-ve dhe platformave të tregtimit, si dhe të pjesëmarrësit të jenë informuar siç duhet. Përveç konsultimit përpara çdo pezullimi, CCP-të njoftojnë pa vonesë autoritetet kompetente përkatëse lidhur me pezullimin e pjesëmarrësit. Autoriteti kompetent informon menjëherë autoritetet përkatëse për pezullimin e një pjesëmarrësi.

Neni 46

Rishikimi i modeleve, testimi i stresit dhe vlerësimi bazuar në të dhëna historike

1. CCP-ja rishikon rregullisht modelet dhe parametrat e miratuara për llogaritjen e kriteve të saj të marzhit, kontributeve të fondit të mospërmbushjes, kërkesave të kolateralit dhe mekanizmave të tjerë të kontrollit të riskut. Modelet duhet të testohen nëpërmjet stress testeve frekvente për të vlerësuar rezistencën e tyre në kushte ekstreme por të mundshme tregu dhe duhet të kryhen teste bazuar mbi të dhënat historike për të vlerësuar besueshmërinë e metodikës së zbatuar. CCP-ja merr konfirmim të pavarur dhe informon Autoritetin për rezultatet e testeve të kryera. Marrja e konfirmimit bëhet në përputhje me pikën 2 shkronjat a) deri në d), të këtij neni, përpara se të miratojë ndryshime të rëndësishme në modele e parametra.
2. Modelet dhe parametrat e miratuara, duke përfshirë ndryshimet e rëndësishme që u bëhen, janë në përputhje me pikat e mëposhtme:
 - a) Kur CCP-ja kërkon të miratojë ndryshime të rëndësishme në modelet dhe parametrat e përmendura në pikën 1, ajo i paraqet kërkesë Autoritetit për konfirmimin e këtij ndryshimi. CCP-ja ua bashkëlidh konfirmimin e pavarur të ndryshimit të synuar kërkesave të saj.
 - b) Autoriteti i konfirmon CCP-së marrjen e kërkesës së plotë:
 - i. brenda 50 ditëve pune nga marrja e kërkesave të plota, Autoriteti kryen një vlerësim risku për ndryshimin e rëndësishëm.
 - ii. brenda 90 ditëve pune nga marrja e kërkesave të përmendura në pikën 2, shkronjën a), Autoriteti informon CCP-në dhe anasjelltas, me shkrim, duke përfshirë një shpjegim të plotë të arsyetuar për dhënien ose refuzimin e konfirmimit.
 - c) CCP-ja nuk mund të miratojë asnjë ndryshim të rëndësishëm të modeleve e parametrave të përmendura në pikën 1 përpara se të marrë konfirmimin nga Autoriteti. Autoriteti mund të lejojë miratimin e përkohshëm të një ndryshimi të rëndësishëm të këtyre modeleve ose parametrave përpara konfirmimit të tyre, kur kjo është e justifikuar.
3. CCP-ja teston rregullisht aspektet kryesore të procedurave të saj të mospërmbushjes dhe hedh të gjitha hapat e arsyeshme për t'u siguruar që të gjithë anëtarët e klerimit t'i kuptojnë ato dhe të hartojnë rregullat e duhura për të reaguar në rast mospërmbushjeje.
4. CCP-ja bën publike informacione kryesore rreth modelit të saj të menaxhimit të riskut dhe supozimeve të miratuara për të kryer testet e stresit.
5. Për të siguruar zbatimin e këtij neni, Autoriteti miraton një model standardesh rregullatore teknike që përcaktojnë:
 - a) Llojin e testeve që duhen ndërmarrë për klasat e ndryshme të instrumenteve dhe portofolave financiare;
 - b) Përfshirjen e anëtarëve të klerimit dhe palëve të tjera në teste;
 - c) Shpeshtësinë e testeve;

- d) Afatet kohore të testeve;
- e) Informacionin kyç të përmendur në pikën 4 të këtij neni.

Neni 47 **Shlyerja**

1. Kur është e mundur dhe kur është e vlefshme, CCP-ja përdor paratë e Bankës Qendrore për shlyerjen e transaksioneve të saj. Në rast se nuk përdoren paratë e Bankës Qendrore, do të merren masa për të kufizuar në mënyrë rigorozë rreziqet e shlyerjes me mjete monetare.
2. CCP-ja deklaron qartë detyrimet e saj lidhur me dorëzimin e instrumenteve financiare edhe nëse ka detyrimin për kryerjen ose marrjen e pagesës në momentin e dorëzimit të një instrumenti financiar ose nëse dëmshpërblen pjesëmarrësit për humbjet e shkaktuara në procesin e dorëzimit.
3. Kur CCP-ja ka detyrim të kryejë ose të marrë pagesa gjatë dorëzimeve të instrumenteve financiare, ajo eliminon rrezikun kryesor përmes përdorimit, për sa është e mundur, të mekanizmave të dorëzimit kundrejt pagesës.

Neni 48 **Raportimi i informacionit**

1. CCP-ja raporton informacione në zbatim të nenit 40 të kësaj rregulloreje tek ata anëtarë klerimi të cilët janë institucione dhe tek Autoriteti.
2. Kur CCP-ja ka më shumë sesa një fond mospërbushjeje, ajo raporton të dhëna për secilin fond mospërbushjeje më vete.
3. CCP-ja i njofton anëtarët saj të klerimit që janë institucione çdo tre muaj ose më shpesh për këta anëtarë klerimi.

KREU VIII **DETYRIMET E PËRGJITHSHME DHE REFERENCAT**

Neni 49 **Detyrimet e përgjithshme**

Shtëpia e klerimit i paraqet Autoritetit një përshkrim të çdo ndryshimi të rëndësishëm në informacionin e dorëzuar më parë në kërkesën e saj, që do të ndikonte në vlerësimin e përputhshmërisë së operatorit ndaj kërkesave në zbatim të nenit 7 të kësaj rregulloreje.

Kur shtëpia e klerimit i dërgon Autoritetit informacion të ri të korrigjuar, përditëson ose sqaron informacionin e paraqitur më parë në përputhje me këtë rregullore, nuk është e nevojshme që ai të përfshijë informacione që janë të një natyre të parëndësishme ose krejt teknike, që nuk ndikojnë në vlerësimin e përputhshmërisë së saj, sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje.

KREU IX DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 50 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

SHTOJCA I

AMF Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

[Lloji i kërkesës: Shtëpi klerimi /CCP]

[Të dhënat identifikuese dhe të kontaktit të subjektit kërkues]

[DATA E KËRKESËS]

PËRMBLEDHJE

DEKLARATË E SUBJEKTIT KËRKUES

Me bindje të plotë dhe bazuar në informacionin dhe të dhënat e paraqitura në kërkesë, ne deklarojmë se i gjithë informacioni dhe të dhënat e paraqitura këtu janë të sakta dhe të drejta dhe se nuk është hequr asnjë informacion apo e dhënë që ndikon në saktësinë dhe plotësinë e informacionit,

nënshkruar nga [përfaqësuesi i autorizuar i subjektit kërkues]

PËRGJEGJËSIA PËR INFORMACIONIN QË PËRMBAN KËRKESA

Subjekti kërkues pranon përgjegjësinë për informacionin dhe të dhënat që përmban kjo kërkesë. Informacioni është në përputhje me faktet dhe nuk lë jashtë asnjë informacion që do të cenonte vlerën e tij. Kur përdoren informacione nga palët e treta, ky informacion riprodhohet me saktësi.

RUBRIKA 1 – Llojet e kërkesës

Kërkesë për licencimin e Shtëpisë së klerimit []	Kërkesë për licencimin e Kundërpalës Qendrore []
------------------------------------------------------	------------------------------------------------------

RUBRIKA 2 – Të dhëna kryesore për subjektin kërkues

Pika 1	Emri dhe forma juridike e subjektit kërkues
Pika 1.1.	Rruga, numri i rrugës, kodi postar, qyteti dhe vendi
Pika 1.2.	Ligji mbi bazën e të cilit vepron subjekti kërkues
Pika 1.3.	Vendi i themelimit i subjektit kërkues

Rubrika 3 – Informacioni i paraqitur nga subjekti kërkues

Rregulloret përkatëse të kësaj rregulloreje (përmendni vetëm ato rregullore që gjejnë zbatim për funksionet, detyrat ose shërbimet e subjektit kërkues)	Numri i referencës i dokumentit	Titulli i dokumentit	Kreu ose rubrika ose faqja e dokumentit ku jepet informacioni ose arsyet pse informacioni nuk është dhënë